

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vengu kundër vendimit të Gjykatës Speciale: “Strehë e padrejtësisë”, kërkon rrëzimin e dënimeve në apel
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajon/vengu-kunder-vendimit-te-gjykates-speciale-strehe-e-pa-drejtësisë-kerkon-r-i586457
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 11:16:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 11:12:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1967cf5135e0901cbaef45daa3590244ba88d8cfff7581dc4918dfd65542637d
TEKSTI	0bbe52011f157fa6c7145af7982c3fbb82983c0075a5321c9066b52a4efcf373
PAMJA	5f3554a134e58363175e7552ed62e16fba7906656601e310f44226c3dc28ca98

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8f7d081d3910391030fe78ec598c0fa2a5e796115da3c81b29b850a8aa9d7629
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	06975047e5a3601e37e96e97bfab995ceed02fbc2c1535a000f7cb9180af2b1a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8f7d081d3910391030fe78ec598c0fa2a5e796115da3c81b29b850a8aa9d7629>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



16 Vengu kundër vendimit të Gjykatës Speciale: “Strehë e padrejtësisë”, kërkon rrëzimin e dënimeve në apel
fundit

Vengu kundër vendimit të Gjykatës Speciale: “Strehë e padrejtësisë”, kërkon rrëzimin e dënimeve në apel



16 Shtator 2026, 13:12Rajoni TEMA



Ish-ministri i Mbrojtjes dhe deputeti i Partisë Socialiste, Pirro Vengu, ka reaguar pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë për dënimin e katër ish-drejtnesve të UÇK-së.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi u dënuan me një total prej 81 vitesh burgim për krime lufte.

Përmes një reagimi në rrjetet sociale, Vengu e cilëson vendimin për krijimin e Gjykatës Speciale si të gabuar dhe shprehet se kjo gjykatë është kthyer, sipas tij, në “strehë të padrejtësisë”.

“Është tashmë e qartë për të gjithë se sa i gabuar ishte vendimi për krijimin e Gjykatës Speciale, e cila sot u bë streha e padrejtësisë”, shkruan Vengu.

Deputeti socialist kundërshtoi gjithashtu faktin që vendimi është dhënë nga një gjykatë e vendosur jashtë Kosovës.

“Ishte rrëqethëse t’i dëgjoje këto dënime të shqiptoheshin ‘në emër të popullit të Kosovës’. Një gjykatë e vendosur jashtë Kosovës dhe pa gjyqtarë nga Kosova përdori emrin e popullit të saj për të dënuar luftëtarët e pavarësisë sonë të dytë”, shprehet ai.

Vengu e vendos vendimin në kontekstin e luftës së Kosovës, duke argumentuar se Kosova ishte viktimë, Serbia e Millosheviçit agresori, ndërsa UÇK-ja luftoi për liri. Ai përmend gjithashtu ndërhyrjen e NATO-s për t’i dhënë fund spastrimit etnik.

Në reagimin e tij, deputeti i PS-së shprehet në mbështetje të katër të dënuarve dhe familjeve të tyre, ndërsa kërkon që vendimi të kundërshtohet në procesin e apelit.

“Këto dënime duhet të rrëzohen në apel. Kosova, Shqipëria dhe shqiptarët, duhet të ndërmarrin çdo hap të mundshëm ligjor dhe institucional”, shkruan Vengu.

Ai thekson se mbështetja ndaj Perëndimit nuk duhet të nënkuptojë heshtje përballë asaj që e konsideron padrejtësi.

“Besnikëria jonë ndaj Perëndimit nuk kërkon heshtje përballë padrejtësisë. Ajo kërkon besnikëri ndaj vetë parimeve mbi të cilat Perëndimi është ngritur: lirisë, barazisë dhe drejtësisë”, shprehet Vengu.

Në përfundim, ai deklaron: “Historia e shqiptarëve nuk mund të falsifikohet në sallat e gjyqit”.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[FOTO 1 / Momenti kur qytetarët e Prishtinës janë në lot pas vendimit të Pages, dënimje e dështim të sheshtet e kryeqytetit](#)

12:50 Rajoni / 5 komente

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Haxhiu: Lajm tronditës për Kosovën, aktgjykimet nuk e rishkruajnë dot historinë](#)

12:40 Rajoni

[VIDEO/ Tension jashtë gjykatës speciale në Hagë, shqiptarët përplasen me policinë. Shoqërohen disa prej tyre](#)

12:30 Rajoni / 4 komente

[“Vendim i papranueshëm dhe i padrejtë”/ Haradinaj pas dënimit të ish-krerëve të UÇK: Beteja për drejtësi duhet të vazhdojë!](#)

12:20 Rajoni / 4 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.